



Në bazë të nenit 40.2 (e) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, dhe nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01-Nr.V-2 të dt.04.05.2010, Ligjit për Planifikim Hapësinorë, si dhe Rregullores Komunale për punën e Këshillit të Ekspertëve të Planifikimit Hapësinorë, Asambleja Komunale e Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.04.2011, bie këtë :

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KËSHILLIT PROFESIONAL PËR PLANIFIKIM HAPËSINORË PËR KOMUNËN E DEÇANIT

I.

Formohet Këshilli Profesional për Planifikim Hapësinorë për Komunën e Deçanit në këtë përbërje:

1. Agim Hulaj,
2. Shkëlzen Shehu,
3. Xheladin Malaj,
4. Ajshe Qorraj,
5. Jeton Mushkolaj,
6. Blerim Bajraktaraj, dhe
7. Musë Mushkolaj.

Këshilli do ta zgjedhë kryetarin e vet në mbledhjen e parë konstituive e cila do të ftohet nga kryesuesi i Asamblesë.

II.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Profesional janë:Ep mendime, propozime dhe vërejtje në dokumentet e planifikimit hapësinorë(Planin Zhvillimor të Komunës, Planin Zhvillimor urban, Planin rregullues urban dhe planet për zona të veçanta) si dhe dokumente tjera të përcaktuara me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinorë, shqyrton dhe propozon zgjidhjet përkatëse në rastet e mosharmonizimit të strategjive zhvillimore për sektorë të ndryshëm të rëndësishëm për planifikim hapësinorë.

-Përcjellë dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet e planifikimit hapësinorë.

-Kryen edhe punë tjera të cilat dalin nga aktet juridike të Kuvendit të Komunës nga fusha e planifikimit hapësinorë.

III.

Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit.

IV.

Me nga një kopje të Vendimi paisen,Të emruarit nga pika I. e Vendimit dhe Arhivi.

01.Nr.IV-7

Deçan,dt.29.04.2011

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj